



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:001428

Datë: 12.10.2021

Numri i dokumentit: 02267912

C.nr.20/20

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Besnik Bislimaj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve A. Xh. – Th. nga Gjakova, I. M. - Sh. nga Gjakova, B. H. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, B. M. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, S. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, V. G. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës dhe Xh. C. nga Gjakova, të cilët i përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit në emër të ushqimit në punë (shujtës) dhe shpenzimeve të transportit, vlera e kontestit 11,174.90 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore publike të datës 23.08.2021, me datë 12.10.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve A. Xh. – Th. nga Gjakova, I. M. - Sh. nga Gjakova, B. H. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, B. M. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, S. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, V. G. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës dhe Xh. C. nga Gjakova, ashtu që

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të kompensimit për ushqimin për praninë në punë dhe shpenzimet e transportit, të paguajë:

- Për paditësen A. Xh. – Th. nga Gjakova,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej **1,114.00.-€** (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësen I. M. – Sh. nga Gjakova,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej 1,114.00.-€ (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro. në emër të shpenzimeve të transportit, shumën prej 130.90.-€ (njëqind e tridhjetë euro e nëntëdhjetë cent) për 187 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 05.10.2018, duke llogaritur 70% të biletës së trafikut urban prej 0.50 euro (një drejtim) në relacionin Gjakovë – Skivjan, respektivisht shumën e përgjithshme prej **1,244.90.-€** (njëmijë e dyqind e dyzet e katër euro e nëntëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij

aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësin B. H. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej 1,114.00.-€ (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro. Në emër të shpenzimeve të transportit, shumën prej 691.90.-€ (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë cent) për 494 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 08.01.2020, duke llogaritur 70% të biletës së trafikut urban prej 1.00 euro (një drejtim) në relacionin . . . – Gjakovë, respektivisht shumën e përgjithshme prej **1,805.60.-€** (njëmijë e tetëqind e pesë euro e gjashtëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësin B. M. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës ,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej 1,114.00.-€ (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro. Në emër të shpenzimeve të transportit, shumën prej 1,037.40.-€ (njëmijë e tridhjetë e shtatë euro e dyzet cent) për 494 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 08.01.2020, duke llogaritur 70% të biletës së trafikut urban prej 0.50 euro (një drejtim) në relacionin . . . – Gjakovë, respektivisht shumën e përgjithshme prej **2,151.40.-€** (dymijë e njëqind e pesëdhjetë e një euro e dyzet cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësin S. B. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës ,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej 1,114.00.-€ (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro. Në emër të shpenzimeve të transportit, shumën prej 1,037.40.-€ (njëmijë e tridhjetë e shtatë euro e dyzet cent) për 494 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 08.01.2020, duke llogaritur 70% të biletës së trafikut urban prej 0.50 euro (një drejtim) në relacionin . . . – Gjakovë, respektivisht shumën e përgjithshme prej **2,151.40.-€** (dymijë e njëqind e pesëdhjetë e një euro e dyzet cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësin V. G. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej 1,114.00.-€ (njëmijë e njëqind e katërbëdhjetë euro) për 557 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro. Në emër të shpenzimeve të transportit, shumën prej 691.90.-€

(gjashtëqind e nëntëdhjetë e një euro e nëntëdhjetë cent) për 494 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 08.01.2020, duke llogaritur 70% të biletës së trafikut urban prej 1.00 euro (një drejtim) në relacionin . . . – Gjakovë, respektivisht shumën e përgjithshme prej **1,805.60.-€** (njëmijë e tetëqind e pesë euro e gjashtëdhjetë cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 10.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

- Për paditësen Xh. C. nga Gjakova,

Në emër të shujtës ditore, shumën prej **902.00.-€** (nëntëqind e dy euro) për 451 ditë të pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 08.01.2017 e gjer më 08.01.2020, duke llogaritur për secilën ditë të punës në shumë nga 2 euro, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 12.10.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësve të iu paguajë shumën totale prej **777.60 euro**, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor i çështjes është mbajtur në mungesë të të paditurës, në kuptim të nenit 423 par.4 të LPK-së.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit A. Xh. – Th. nga Gjakova, I. M. - Sh. nga Gjakova, B. H. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, B. M. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, S. B. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, V. G. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës dhe Xh. C. nga Gjakova, përmes te autorizuarit të tyre Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, me datë 08.01.2020 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar kompensimin për ushqim në emër të ditëve të pranisë në punë (për secilin ditë të pranisë në punë nga dy euro) si dhe shpenzimet e udhëtimit. Paditësit janë të punësuar në sektorin e arsimit dhe atë pranë shkollës “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë. Paditësit kërkojnë të realizojnë kërkesat e tyre periodike trevjeçare prej 08.01.2017 e deri më sot. Kësisoj paditësit kërkojnë të realizojnë kërkesat e tyre trevjeçare sa i përket shujtave 2 euro në ditë, ndërsa paditësit I. M. – Sh., B. H., B. M., S. B. dhe V. G., kërkojnë edhe kompensim për shpenzimet e udhëtimit, meqë të njëjtit udhëtojnë për në vendin e punës. Paditësit i kanë ushtruar kërkesë jashtëgjyqësore të paditurës dhe atë me datën 06.12.2019, duke i kërkuar kompensimin e shujtave dhe transportit, por e paditura ka heshtur dhe nuk është përgjigjur edhe pse në bazë të Ligjit të Punës ka qenë e obliguar të përgjigjet brenda 15 ditëve. Prandaj, meqenëse e paditura ka dështuar në pagesën e shujtave ditore paditësit tash kanë vendosur që të ushtrojnë padi dhe kompensimin ta realizojnë nëpërmjet kësaj gjykate. Kanë kërkuar që kërkesëpadiat e tyre të aprovohet dhe të detyrohet e paditura që të iu kompensojë shumat e caktuara në emër të shujtave ditore prej dy euro në emër të ditëve të pranisë në punë si dhe kompensimin në emër të shpenzimeve të transportit, si dhe kanë kërkuar kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës. Me datë 19.08.2021 i autorizuari i paditësve av. Ilir Rogova nga Gjakova, ka bërë precizimin e kërkesëpadiasë ashtu që për paditësit 1-6 ka kërkuar kompensimin e shujtave ditore për 557 ditë pune, për paditësen I. M.-Sh. nga Gjakova e ka

precizuar kërkesën sa i përket shpenzimeve të transportit ku tani kërkon kompensimin për 187 ditë pune, duke sqaruar se e njëjta punën bazë e ka në shkollën “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, por ka udhëtuar për në fshatin Skivjan, përkatësisht në shkollën “Ukshin Miftari” për 187 ditë, për shkak të plotësimit të normës, sipas vendimeve të të paditurës dhe sipas Kontratës së Punës.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i paditësve Ilir Rogova, avokat në Gjakovë ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe parashtresës së datës 19.08.2021, me të cilën parashtresë është bërë rritja e lartësisë së kërkesës për shkak se paditësit kanë punuar për dy ditë pune më shumë se sa që është thënë në padi. Për paditësen e dytë I. M.-Sh. është bërë zvogëlimi i lartësisë së kërkesës për shpenzimet e transportit për shkak se e njëjta ka udhëtuar më pak ditë pune se sa që është thënë në padi. Sa i përket përgjigjes në padi, e njëjta është në tërësi deklarative për shkak se e paditura nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do të mund të kundërshtonte bazën e padisë apo lartësinë e kërkesëpadisë. Gjersa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar baza e padisë dhe lartësia e kërkesëpadisë së precizuar me parashtresën e datës 19.08.2021. Faktin se ku banojnë padisëit nuk është kontestuar nga e paditura e as fakti se ku gjenden shkollat dhe rrjedhimisht gjykata duhet të prezumojë se të njëjtit kanë ofruar ashtu siç është precizuar me parashtresën e sipërcekut. Njëkohësisht për paditësen I. M.-Sh. sqarojmë se puna bazë ka qenë në shkollën “Nexhmedin Nixha”, mirëpo sipas vendimit të të paditurës dhe për periudhën e objektit të këtij kontesti e njëjta ka qenë e obliguar të udhëtojë për gjithsej 187 ditë pune, për në fshatin Skivjan. I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 60.00 euro, në emër të përpilimit të padisë me shumë paditës shumë prej 312.00 euro, në emër të përfaqësimit në seancë shumë prej 405.60 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 777.60 euro.

E paditura në përgjigjen në padi kaq theksuar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj.. dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kërkesa për kompensimin e shujtës ditore e datës 15.12.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1411 e datës 01.09.2016, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1998/I e datës 01.09.2017, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/2553 e datës 01.09.2018, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/3037 e datës 02.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/3123 e datës 02.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 568 e datës 01.09.2017, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/489 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/529 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/504 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 3048 e datës 01.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1447 e datës 01.09.2016, Vendimi i lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit me numër të protokollit 2134 e datës 06.02.2017, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Ukshin Miftari” me numër të protokollit 841/21 e datës 18.08.2021, Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë e datës 12.11.2019 dhe vërtetimi i datës 28.12.2019, Vërtetimi i lëshuar nga SHMLT “Nexhmedin Nixha” e datës 29.06.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërjegje ka çmuar

çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **e bazuar**.

Nga Kërkesa për kompensimin e shujtës ditore e datës 15.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i autorizuari i paditësve ka kërkuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve të iu kompensojë shpenzimet e shujtes.

Nga Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1411 e datës 01.09.2016, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1998/I e datës 01.09.2017, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/2553 e datës 01.09.2018, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/3037 e datës 02.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/3123 e datës 02.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 568 e datës 01.09.2017, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/489 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/529 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/504 e datës 01.09.2015, Kontrata e punës me numër të protokollit 3048 e datës 01.09.2019, Kontrata e punës me numër të protokollit 43/1447 e datës 01.09.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit janë të punësuar tek e paditura.

Nga Vendimi i lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit me numër të protokollit 2134 e datës 06.02.2017, gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses Xh. C. i është aprovuar kërkesa për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë për periudhën 6 mujore duke filluar nga data 10.01.2017 deri me datë 10.07.2017.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “ Ukshin Miftari” me numër të protokollit 841/21 e datës 18.08.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja I. M. - Sh. nga Gjakova nga data 10.01.2017 deri me 05.10.2018 ka realizuar gjithsej 187 ditë mësimi.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë e datës 12.11.2019 dhe vërtetimi i datës 28.12.2019, gjykata ka vërtetuar çmimet për relacionet përkatëse, përkatësisht për relacionin Gjakovë – . . . çmimi i biletës kushton 1.00 euro (një drejtim), për relacionin Gjakovë – Skivjan çmimi i biletës kushton 0.50 euro (një drejtim), për relacionin Gjakovë – . . . çmimi i biletës kushton 1.50 euro (një drejtim), për relacionin Gjakovë – . . . çmimi i biletës kushton 1.00 euro (një drejtim) dhe për relacionin Gjakovë – . . . çmimi i biletës kushton 1.50 euro (një drejtim).

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHMLT “Nexhmedin Nixha” e datës 29.06.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit A. Xh. – Th. nga Gjakova, I. M. - Sh. nga Gjakova, B. H. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, B. M. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, S. B. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, V. G. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës në këtë institucion arsimor përkatësisht në SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë kanë punuar gjithsej 557 ditë, ndërsa paditësja Xh. C. nga Gjakova, për shkak se e ka shfrytëzuar pushimin e lehonisë nga data 10.01.2017 deri me 10.07.2017, e njëjta ka punuar gjithsej 451 ditë pune.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata nga administrimi i provave dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar se nuk është kontestues faktin se paditësit për periudhën kohore 2017/2018, 2018/2019 dhe 2019/2020 deri me 08.01.2020, për të cilën kërkojnë kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimeve të transportit kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht Shkollën e Mesme të Lartë Teknike “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë.

Sa i përket kërkesës së parë, lidhur me pagesën e shujtave ditore, gjykata nga provat në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura, gjegjësisht drejtori i Shkollës

së Mesme të Lartë Teknike “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë me datë 29.06.2020, ka vërtetuar se paditësit A. Xh. – Th. nga Gjakova, I. M. - Sh. nga Gjakova, B. H. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, B. M. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, S. B. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, V. G. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës në këtë institucion arsimor përkatësisht në SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë kanë punuar gjithsej 557 ditë, ndërsa paditësja Xh. C. nga Gjakova, për shkak se e ka shfrytëzuar pushimin e lehonisë nga data 10.01.2017 deri me 10.07.2017, e njëjta ka punuar gjithsej 451 ditë pune. Andaj, në rastin konkret, gjykata kur vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, iu referua nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017, në të cilën parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. E po ashtu, një gjë të tillë e ka paraparë edhe Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nr.36 e cila ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015, e cila në nenin 54 par.1 ka përcaktuar se *“të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete.”* Në këtë rast, gjykata paditësve iu ka aprovuar shumën nga 2 euro për çdo ditë pune të pranisë në punë, shumë kjo e përcaktuar në Kontratën Kolektive të Arsimit dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Sa i përket kërkesës së dytë, në lidhje me shpenzimet e transportit për paditësit I. M. – Sh., B. H., B. M., S. B. dhe V. G., gjykata nga provat në shkresat e lëndës, konkretisht nga Letërnjoftimi i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ka vërtetuar faktin se paditësja I. M. – Sh. jeton në Gjakovë, paditësi B. H. jeton në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, paditësi B. M. jeton në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, paditësi S. B. jeton në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, ndërsa paditësi V. G. jeton në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës. Meqenëse të njëjtit punojnë në SHMLT “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë, për gjykatën nuk është kontestuese se për të shkuar në punë paditësit duhet të udhëtojnë, prandaj në rastin konkret, duke aplikuar nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit ku është përcaktuar se *“punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh se me Kontratën Kolektive të Arsimit në nenin 35 par.5 është përcaktuar pagesa e shpenzimeve për transport prej 70% të biletave të trafikut urban dhe meqë gjykata e ka vërtetuar lartësinë e biletave përmes vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, gjykata paditësve të lartcekur iu ka aprovuar kërkesën për shpenzimet e transportit si në dispozitivin **II** të këtij aktgjykimi.

Gjykata po ashtu ka vërtetuar edhe faktin se punëdhënësi i paditësve është pikërisht e paditura me çka vërtetohet edhe nga kontratat e punës dhe vërtetimet përkatëse që gjenden në shkresat e lëndës, andaj raporti juridik i paditësve me te paditurën të njëjtën e bën legjitime dhe me detyrim për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, po ashtu me rastin e vendosjes pati parasysh edhe nenin 90, par.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në të cilën parashihet *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, ndërsa në nenin e përcaktuara të lartëcituar është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret të paditurës për kompensimin e ushqimit në punë dhe shpenzimet e transportit edhe pse të njëjtit nuk janë nënshkruar të Kontratës Kolektive të Arsimit, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë

nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh edhe kundërshtimet e përfaqësuesit ligjor të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, në lidhje me atë se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve të kërkuara, mirëpo gjykata këto pretendime i refuzoi si të pa bazuar për arsye se paditësit nuk janë përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga kontrata e lartcekur. Përveç kësaj dispozita e nenit 46 të kësaj kontrata ka karakter udhëzues e jo imperativ apo detyrës dhe se nuk është bazë juridike për refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që të njëjtat nuk kanë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 paragrafi 1 te LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 60.00 euro, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 312.00 euro, në emër të prezantimit në seancë shumë prej 405.60 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 777.60 euro.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.20/20, datë 12.10.2021

Zyrtare ligjore
Merita Xharavina

GJYQTARI,
Besnik Bislimaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.